



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost  
Kosovo Academy for Public Safety

**15.02.2019**

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, shpall këtë:

**KONKURS**  
**për plotësimin e vendeve të lira të punës**

<b>Pozita:</b>	Përkthyes shqip-serbisht-shqip
<b>Numri i konkursit:</b>	APF0004738
<b>Kategoria/koeficienti:</b>	Nivel profesional, koeficienti 7
<b>Numri i vendeve të punës:</b>	4 (katër)
<b>Orari i punës:</b>	I plotë
<b>Raporton të:</b>	Udhëheqësi i Divizionit të Përkrahjes Gjuhësore

**Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës:** Ofrimi i shërbimeve të përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas, në formën verbale dhe të shkruar.

**Detyrat dhe përgjegjësit kryesore**

1. Kryen detyra sipas kërkesës në fushën profesionale të përkthimit verbal nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas për të gjitha trajnimet dhe aktivitetet tjera që zhvillohen në AKSP.
2. Kryen detyra sipas kërkesës në fushën profesionale të përkthimit dhe të përshtatjes së formës së shkruar nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas, duke aplikuar terminologjinë e unifikuar gjuhësore;
3. Kryen detyrat në fushën e përkthimit konsektiv dhe simultant, nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas për të gjitha aktivitetet të cilat zhvillohen në AKSP;
4. Kryen detyrat në fushën profesionale të përkthimit verbal në trajnimet që zhvillohen në salla sportive, terrene (poligone).

5. Merr pjesë aktive në grupe punuese në fushën e përkthimit si dhe në analizën e nevojave të shërbimit në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të divizionit duke prezantuar ide alternative dhe kreative;
6. Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij me palët e interesit për shkëmbimin dhe zhvillimin e punës në fushën e përkrahjes gjuhësore;
7. Raporton rregullisht tek mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planin e punës së miratuar;
8. Kryen çdo detyre tjetër në fushën e përgjegjësisë profesionale të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;

### **Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:**

- Njohuri dhe përvojë në fushën e përkthimeve, shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).
- Diplomë universitare në njërin nga drejtimit: Filologjik, Juridik, Ekonomik, Administratë Publike apo shkenca tjera shoqërore, dhe se paku dy (2) vite përvojë pune (pas diplomimit).

### **Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim**

Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave që kërkojnë për pozitën përkatëse.

### **Procedura e konkurimit**

Procedura e konkurimit është publike (për gjithë të interesuarit).

### **Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin**

Rekrutimi bëhet në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si dhe Rregulloren Nr.07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil.

### **Kohëzgjatja e emërimit**

Emërimi është me kohë të pacaktuar (karrierës), periudha provuese 12 muaj.

### **Data e mbylljes së konkursit**

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit, duke filluar nga data 15.02.2019 deri me datën 01.03.2019.

## **Paraqitja e kërkesave**

Aplikacionet dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri, Zyra e Personelit nr.1. Kandidatet e interesuar aplikacionin mund ta shkarkojnë në adresën elektronike: [www.aksp-ks.net](http://www.aksp-ks.net) . Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohet për vendin e punës për të cilin konkurroni.

***“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.***

***“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.***

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen

Për informata me te hollësishme mund te kontaktoni Zyrën e Personelit nr. tel: 028 590 070 Ext 210, 211 ose 212, prej orës 08:00 - 1600.